



REPUBLIKA E KOSOVËS \* REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit \* Opština Prizren  
Prizren Beledijesi  
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 614/24 Dt. 07.10.2024



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Sindikatës së Policisë së Kosovës, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa e Sindikatës së Policisë së Kosovës nr. 01-13-24 e datës 25.09.2024, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e lojërave tradicionale (sportive) në Prizren të cilat do të mbahen me datën 24, 25 dhe 26 tetor 2024, për nder të zyrtarëve policor të rënë në detyrë, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve për akomodimin e mysafirëve që marrin pjesë në këtë aktivitet dhe që janë përfaqësues të sindikatave të Policisë në rajon dhe më gjerë, lejohen mjetet e nevojshme financiare.
2. Mbulimi i shpenzimeve të akomodimit lejohet për datat e lartcekura në këtë vendim.
3. Mjetet e lartcekura do të lejohen pas parashtrimit të faturave përkatëse.
4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallra dhe shërbime.
5. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës  
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
  - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
  - Arkivës së Kryetarit.

